



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA

Datë:15/11/2022
KPSHCK/02/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil /Njësia e Burimeve Njerëzore në pajtim me dispozitat e nenin 18 paragrafi 2 (2.3) të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin, dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitete

Mandati: Anëtarë i Komisionit për pranimin është ad-hoc.

Pagesa: 250 euro për çdo procedurë të rekrutimit në të cilën është angazhuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtarë i Komisionit për pranimin dhe do të kryej detyrat e tij ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Kriteret për aplikim:

1. Të kenë diplomë universitare me të paktën 240 kredi në fushën e specializimit ligjor (në rastet kur është marr jashtë vendit duhet të silltet dëshmi mbi nostrifikimin);
2. Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtuese;
3. Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
4. Të kenë integritet moral dhe profesional;
5. Të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;
6. Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës.

Organizatave të specializuara duhet t'i ofrojnë për kandidatët e tyre të dhënat e sakta mbi adresën dhe numrin e telefonit kontaktues.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë organizatat e specializuara që të plotësojnë kriteret e shpalljes të aplikojnë.

Shpallja mbetet e hapur nga datë **15/11/2022** deri më **21/11/2022**

Për aplikim dhe informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 10-459 ose në e-mail adresën: bukurije.burjani@rks-gov.net